

RAPORT

Votimi nga jashtë vendit në zgjedhjet e 11 majit

Ecuria dhe rezultatet e një procesi risi

Maj 2025

Ky raport u zhvillua në kuadër të projektit “*Partneritete të forta për reforma të qëndrueshme - Forcimi i rolit të shoqërisë civile në adresimin e sfidave të zgjedhjeve të lira dhe të drejta*”, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta përmes programit MATRA. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi vetëm e ekipit realizues të APS & IPS dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e ambasadës.

AKADEMIA E STUDIMEVE POLITIKE
Rr. Emin Duraku, Pallati Credins, kati 7, Tiranë
Tel: +355 4 5629047, E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE
Rezidenca "Garden Side", Rr " Faik Konica", Kati
1, Ap. 3, Tiranë Email: contactaips@isp.com.al
Web: www.isp.com.al

HYRJE

Votimi nga jashtë vendit apo vota e diasporës u mundësua për herë të parë në zgjedhjet e 11 maj 2025 si një risi që mund të krijonte premisat për rritjen e numrit të votuesve dhe përfaqësimin politik, por edhe ofrimin e një votuesi më të sigurtë nga presionet apo fenomenet e tjera negative në zgjedhje.

Sipas INSTAT, në vitin 2020 [përlllogaritej](#)¹ se rreth 1.68 milionë qytetarë, apo rreth 37% të popullsisë shqiptare jetonin jashtë territorit të Shqipërisë. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre votuesve e kishin të pamundur të udhëtonin ditën e zgjedhjeve në atdhe duke humbur mundësinë për të ushtruar të drejtën e votës.

Partia Socialiste u zotua në vitin 2017 se do të garantonte votën e diasporës në zgjedhjet e ardhshme parlamentare dhe këtë zotim e vendosi si një prej kërkesave të saj në diskutimet e të ashtuquajturit Këshilli Politik, platformës politike të ndërtuar nga Kuvendi për të diskutuar reformën zgjedhore të vitit 2020. Pas dakordësimit në marrëveshjen politike të 5 qershorit 2020, ndryshimet e Kodit Zgjedhor të votuara nga Kuvendi me [ligjin nr. 101/2020](#), datë 23 korrik 2020, përfshinë të drejtën e shqiptarë me banim të përhershëm jashtë territorit për të votuar në zgjedhjet parlamentare.

Pas dështimit të politikës shqiptare për të realizuar këtë zotim në zgjedhjet e vitit 2021, organizatat përfaqësuese të diasporës zhvilluan një betejë ligjore në Gjykatën Kushtetuese dhe angazhimin e duhur publik për sigurimin e kësaj të drejte në zgjedhjet e ardhshme. Përballë këtij presionit pozitiv, partitë pjesë e komisionit të posaçëm parlamentar të Reformës Zgjedhore dakordësuan në korrik 2024 që të mundësonin votën nëpërmjet shërbimit postar nga jashtë vendit.

Hapat drejt votës së diasporës

5 qershor 2020

Marrëveshja në të ashtuquajturin Këshillin Politik dakordëson parimisht edhe për votën e diasporës.

23 korrik 2020

Kuvendi miraton ndryshimet në Kodin Zgjedhor, duke futur në rrugë institucionale procesin e votës së diasporës.

Tetor 2020

Konstituimi i KQZ të re. Komisioneri Shtetëror dhe Ministri i Shtetit për Diasporën nisin konsultimet me Diasporën për të mundësuar aktet nënligjore.

¹ INSTAT – Të dhënat statistikore për diasporën - <https://ëëë.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>

Janar 2021

Ngec draftimi i akteve normative dhe procesi konsiderohet i pamundur nga Komisioneri për zgjedhjet e vitit 2021 pa ndërhyrje nga Kuvendi.

Shkurt 2022

Organizata “Diaspora Për Shqipërinë e Lirë” dorëzon padi në Gjykatën Kushtetuese.

Gusht 2022

Përfundon draftimi i aktit të parë nënligjor - Regjistrimi i zgjedhësve jashtë vendit. Komisioneri nxjerr urdhër me shkrim që të gjitha aktet të përfundojnë deri në Shtator 2023.

Tetor 2022

Partive politike u kërkohet të japin urgjentisht mendimet e tyre rreth aktit të parë. Pas miratimit, fillon puna për draftimin e akteve të tjera.

9 dhjetor 2022

Burimi: Faqja e internetit e “Diaspora për Shqipërinë e Lirë”

Përballë këtij presionit pozitiv, partitë pjesë e komisionit të posaçëm parlamentar të Reformës Zgjedhore dakordësuan në korrik 2024 që të mundësonin votën nëpërmjet një shërbimi postar privat ndërkombëtar.

Gjykata Kushtetuese konstaton cenimin e së drejtës kushtetuese të votës së diasporës për shkak të boshllëkut ligjor. I kërkohet Kuvendit plotësimi i boshllëkut ligjor brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

9 janar 2024

Tejkalohet afati një vjeçar. Diskutimet në komisionin e posaçëm parlamentar për Reformën Zgjedhore ngrenë pikëpyetje nëse është e nevojshme të ndryshojë Kodi Zgjedhor apo KQZ mund të mundësojë votimin nëpërmjet plotësimit me akte nënligjore.

26 korrik 2024

Miratohen nga Kuvendi ndryshimet e Kodit Zgjedhor që parashikojnë specifikimet për votën nga jashtë.

17 shkurt 2025

Ndryshime të reja në Kodin Zgjedhor për të procedurën e regjistrimit të votuesve nga jashtë dhe detaje të tjera.

Procesi i regjistrimit dhe votimit

Pavarësisht vonesave kohore në dakordësinë politike dhe mungesës së besimit nga opozita për shërbimin postar që mund të përdorej për votimin e diasporës, Komisioni Rregullator pranë KQZ arriti që të miratonte aktet nënligjore të nevojshme më 20 mars 2025.

Regjistrimi në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) pranë KQZ u zhvillua në një afat kohor 2 mujor (11 janar - 9 mars), përkundër kërkesave për shtyrje afati nga Partia Demokratike.

Procesi i regjistrimit paraqiti sfida të konsiderueshme. Problematika kryesore e hasur në këtë proces ishte sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm nga emigrantët për të provuar adresën e tyre dhe mundësuar dërgimin e fletëve të votimit. Kjo problematikë është e kuptueshme në një proces që zhvillohet për herë të parë dhe problematikave në dokumentacion të emigrantëve që nuk kanë mundur të sigurojnë lejet e qëndrimit në vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Gjatë këtyre muajve u publikuan në media raste të ngritjes së zyrave të Partisë Socialiste, kryesisht në Greqi dhe Itali, ku ofrohej ndihma për emigrantët për të kryer regjistrimin në sistemin e KQZ. Opozita ngriti shqetësimin se këto zyra mblidhnin informacion për të kryer patronazhimin e votës së emigrantëve.


Nga totali prej 365.166 kërkesa për regjistrim nga diaspora të kryera nga 294.155 zgjedhës, u regjistruan si votues nga jashtë 245.975 zgjedhës, dhe u refuzua kërkesa për 48.180 zgjedhës. Gjashtë qytetarë u regjistruan pas ankimimit në gjykatë. Buxheti i akorduar nga qeveria mbuloi koston për shërbimin postar duke mundësuar votimin pa asnjë kosto në 85 shtete të botës ku jetonin emigrantët e regjistruar. Kompania ndërkombëtare DHL, e cila u ofrua për të mundësuar këtë shërbim, kërkoi një kosto mesatare rreth 40 euro për person për shërbimin. Sipas KQZ, në tërësi, kostoja e përllogaritur e shërbimit postar arrinte në 9 milionë e 839 mijë euro.

Procesi i shpërndarjes së fletëve të votimit nga kompania private DHL, në periudhën 10-23 prill, u shoqërua me disa denoncime për parregullsi si mosdorëzimin personal të zarfeve, probleme komunikimi me kompaninë dhe si pikë më e kundërshtuar nga opozita, nënkontraktim të paautorizuar të një operatori tjetër në Greqi. Shërbimi privat DHL e argumentoi këtë praktikë si një procedurë normale në Greqi, duke marrë parasysh numrin e lartë të ishujve në këtë vend. Për të adresuar situatën, KQZ krijoi një mekanizëm raportimi në PER dhe i kërkoi kompanisë postare sqarime zyrtare. Një çështje e kontestuar ishte gjithashtu edhe marrja e zarfeve në zyrat postare në ditët e fundit dhe dorëzimi i tyre dorazi për shkak të vonësës së korrierëve postarë për të gjetur adresën e votuesve.

Pavarësisht këtyre sfidave, mbi [79% e zgjedhësve](#) të regjistruar (195.853 votues) arritën të ushtronin të drejtën e votës, me zarfet që mbërritën brenda afatit ligjor. Një shifër e kënaqshme duke patur parasysh që zhvillohej për herë të parë si proces dhe shtrirjen e lartë të emigrantëve shqiptarë.

Përkundër pritshmërive, vota e diasporës ka shpërblyer edhe më thellë se brenda vendit mazhorancën socialiste. Sipas të [dhënave zyrtare](#), PS regjistroi 61.12 % të votave të emigrantëve përkundër 52.14% brenda vendit (9 % më shumë), ndërkohë që për koalicionin

opozitar ky raport prezantohet me një rënie prej gati 11 përqind në diasporë në krahasim me votën e saj brenda territorit shqiptar.



Burimi: KQZ

Nevojitet të analizohen më tej arsyet e kësaj rritjeje të votave të mazhorancës në diasporë, përkundër pritshmërive se votuesit jashtë vendit janë më të lirë për të votuar pa ndikimet e pushtetit brenda vendit.

Përfundime dhe rekomandime

Duke marrë në konsideratë që ky proces zbatohet për herë të parë, votimi i diasporës mund të konsiderohet një arritje pozitive dhe objektiv i realizuar me sukses nga KQZ. Në aspektin e standardeve zgjedhore dhe rezultateve të prodhoi garantimi i kësaj vote, për fat të keq u konstatuan edhe në diasporë të njëjtat problematika të zgjedhjeve brenda vendit. Disa prej tyre renditen më poshtë:

Përfaqësimi i diasporës

Votat e diasporës nuk arritën të prodhonin përfaqësues të interesit dhe zërit të tyre në Kuvendin e Shqipërisë. Mungesa e një zonë zgjedhore nuk krijoi premisat për mandatimin e partive apo kandidatëve të orientuar ndaj shqiptarëve jashtë vendit.

Eksportimi i patronazhimit

Partitë politike dhe kryesisht PS, shtrinë format e tyre të patronazhimit të votuesit edhe jashtë territorit të vendit. Raste të kontaktimit nga të afërmit, aktiviteve me të zgjedhur vendorë apo edhe zyrtarë të tjerë të lartë qendrorë në vendet fqinje, si forma të ushtrimit të ndikimit ndaj vullnetit të zgjedhësve.

Shkeljet zgjedhore

Fotografimi i votës nga votuesit jashtë vendit apo edhe votimi nga një person i familjes për të gjithë anëtarët, u konstatua përsëri si një formë e ushtrimit të presionit apo sigurimit të përfitimeve të votuesve përkundrejt mbështetjes së ofruar politike.

Mungesa e programeve

Votuesit nga jashtë vendit nuk patën mundësi të informohen mbi programet e partive politike apo të bëheshin pjesë e debateve politike të kandidatëve, forma të rëndësishme për të mundësuar zgjedhjen e alternativave të duhura.

Fushata elektorale dhe mediat

Për votuesit jashtë vendit mediat mbeten e vetmja mundësi informimi për zhvillimet në vend. Edhe në këto zgjedhje fushata elektorale u mbulua me materiale të gatshme të forcave politike duke forcuar rrezikun e zgjedhësve të painformuar në diasporë.

Në kuadër të këtyre konstatimeve të para pas përfundimit të procesit, mund të paraqiten disa rekomandime të nevojshme për zgjedhjet e ardhshme:

Plotësimi i kuadrit ligjor për votën e diasporës

Procesi i votimit nga jashtë duhet të plotësohet më tej me akte ligjore për të rregulluar financimin e fushatave elektorale dhe transparencën për palët e treta në fushatë. Mungesa aktuale e rregullimeve mund të krijojë premisat për influencimin e këtij elektorati nga aktorë të huaj dashakeqës shtetërore dhe privatë. Në këto kushte, vendi ekspozohet ndaj një rreziku të panjohur që në disa vende të tjera ka vendosur edhe për fatin e zgjedhjeve.

Rritja e përfaqësimit të diasporës

Përtej ndryshimeve të sistemit zgjedhor apo orientimit në një zonë zgjedhore të vecantë për diasporën, mund të nxitet propozimi i kandidaturave përfaqësuese të tyre si pjesë e partive kryesore. Në këtë mënyrë mund të sigurohet përfaqësimi i interesave dhe mbikëqyrja e duhur e politikave të premtuara për diasporën.

Efienca në financimin e procesit

Kosto për realizimin e procesit mund të reduktohet në proceset e ardhshme duke hulumtuar forma kontrolli dhe monitorimi të paanësisë së shërbimit postar publik apo forma të votimit elektronik që shtojnë efikasitetin pa cenuar besueshmërinë.

Forcimi i medias së lirë

Krijimi i një mjedisi që mundëson raportimin e lirë të medias gjatë fushatës zgjedhore dhe jo vetëm, është i domosdoshëm për të krijuar perceptimin e duhur të qytetarëve që jetojnë jashtë vendit për zhvillimet në atdhe dhe vendosur në mënyrën e duhur mbi përfaqësuesit e tyre në Kuvend.

Maj 2025